



ANKESË MBI PIRATERINË

DHE/OSE TRANSMETIME NË KUNDËRSHTIM ME LIGJIN¹

Ankesat për:

- *Pirateri (transmetim dhe/ose përsëritje të programeve (kanaleve) të të tretëve pa marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të transmetimit të tyre;*
- *Transmetimin e programeve, përfshirë veprat kinematografike, pa marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre veprave;*
- *Veprimtari audio dhe/ose audiovizive të paautorizuar, ose të palicencuar nga AMA;*
- *Pajisjet transmetuese të OSHMA-së që shkaktojnë interferenca të dëmshme, pavarësisht se për përdorimin e tyre është marrë licenca ose autorizimi përkatës nga AMA;*

Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton:

Neni 32

Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive

6. OSHMA-të duhet të transmetojnë programet, përfshirë veprat kinematografike, në përputhje me kushtet dhe afatet për të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre veprave.

Neni 78

Inspektimi i veprimtarisë së të licencuarit/të autorizuarit

1. AMA ka të drejtë të ushtrojë kontroll të veprimtarisë programore, financiare, teknike dhe organizative të mbajtësit të një licence dhe/ose autorizimi, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Çdo inspektim, veçanërisht inspektimi i veprimtarisë programore, nuk duhet të cenojë lirinë e shprehjes. I licencuari bashkëpunon me AMA-n për realizimin e këtij funksioni.

2. AMA autorizon nëpunës të specializuar të administratës së vet apo persona të tjerë të specializuar për të realizuar këtë inspektim nëse:

¹ *Paraqitja e ankesës në formë elektronike nuk përjashton detyrimin e subjektit për të depozituar ankimin administrativ në formë shkresore dhe në përmbushje të kërkesave të parashikuar nga K.Pr.Administrative.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- a) ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, që tregojnë se i licencuari dhe/ose i autorizuari nuk realizon shërbimin në përputhje me kushtet e licencës dhe/ose autorizimit;
- b) realizimi i shërbimit të ofruar nga i licencuari shkakton interferenca;
- c) ka informacion për veprimtari të palicencuar dhe/ose të paautorizuar;
- ç) ka një njoftim të përligjur nga një palë e tretë e interesuar.

....

Neni 79

Monitorimi i spektrit të frekuencave

1. AMA monitoron brezat e frekuencave, të caktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave për transmetime audiovizive, me qëllim që:

- a) përdorimi i frekuencave të dhëna me licencë të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të licencës;
- b) spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të këtij ligji;
- c) të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit audioviziv, që do të përdoren për qëllime private ose publike.

...

Neni 80

Blllokimi i pajisjeve dhe/ose ndalimi i funksionimit të tyre

1. Kur një person fizik apo juridik zhvillon veprimtari në fushën e transmetimeve audio dhe/ose audiovizive, të palicencuar nga AMA, personat e autorizuar nga AMA bllokojnë pajisjet.

...

5. Kur personat e autorizuar nga AMA zbulojnë se pajisjet transmetuese të OSHMA-së shkaktojnë interferenca të dëmshme, pavarësisht se për përdorimin e tyre është marrë licenca ose autorizimi përkatës, kanë të drejtë të bëjnë ndalimin e funksionimit të tyre.

...



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

ANKUESI

EMRI: _____
MBIEMRI: _____
PËRFAQËSUES I SUBJEKTIT _____
ADRESA: _____
E-MAIL: _____
NR. TELEFONI: _____

Subjekti :
Adresa:
Qyteti:

Identifikoni saktë Subjektin ndaj të cilit ankoheni.

Përshkruani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga Subjekti dhe, nëse dispononi dokumente, bashkëlidhini ato:

Përshkruani çfarë kërkoni nga Autoriteti i mediave Audiovizive, në përputhje me ligjin nr. 97/2013 dhe rregulloret përkatëse:

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE